Kronikë

Tiranë/ Iu gjet armë në makinë, arrestohet 28-vjeçari! 2 të tjerë në kërkim (VIDEO)

Një 28-vjeçar është arrestuar nga Forcat 'Shqiponja' pasi iu gjet armë zjarri pistoletë në automjetin që drejtonte në fshatin Domje, Tiranë.

Redaksia
12 Qershor, 09:36 | **Përditesimi: 12 Qershor, 09:50**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Tiranë- Një 28-vjeçar është arrestuar nga Forcat 'Shqiponja' pasi iu gjet armë zjarri pistoletë në automjetin që drejtonte në fshatin Domje, Tiranë.

Në kërkim janë shpallur në kërkim 2 persona pronari i automjetit dhe përdoruesi aktual i tij- ky i fundit dyshohet se i ka dhënë automjetin të riut.

Ndërsa në gjendje të lirë do të hetohet një i mitur, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

LEXO EDHE:
Rikonstruktimi i rrugës Tiranë-Ndroq! Realizohen 38% e punimeve

Efektivët sekuestruan armën e zjarrit pistoletë dhe një sasi municioni luftarak, si provë materiale.

> *"Si rezultat i kontrolleve të befasishme të kryera nga shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në automjete të ndryshme, është goditur një rast i armëmbajtjes pa leje. Në fshatin Domje, gjatë kontrollit në automjetin me drejtues shtetasin F. M. dhe pasagjer një shtetas 16 vjeç, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri pistoletë dhe një sasi fishekësh.*
>
> *Në vijim të veprimeve për këtë rast, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vorë:*
>
> *-arrestuan shtetasin F. M., 28 vjeç, banues në Domje, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit";*
>
> *-referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për 16-vjeçarin, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit";*
>
> *-u shpallën në kërkim shtetasit R. T., 24 vjeç, banues në Domje, pronari i automjetit, dhe V. B., 24 vjeç, banues në Domje, përdoruesi aktual i automjetit, pasi dyshohet se i ka dhënë automjetin 28-vjeçarit.*
>
> *Vijon puna për kapjen e shtetasve në kërkim dhe për dokumentimin e rastit", informoi sot policia.*

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: armë zjarri | Tirane

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 11 Qershor, 23:51
Jeni dakord me kërkesën e gjyqtarëve për rritje të pagës me 700 euro?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Kërkuan rinumërimin e votave të tyre, Kolegji Zgjedhor rrëzon ankimimin e Alimehmetit, Kalasë dhe Kuçanës, shtyhet seanca për Shehun! Shkak mungesa e tij

12 Qershor, 10:58

Publikimi i videos së vrasjes së Martin Canit, Prokuroria e Tiranës regjistron procedim penal për zbulimin e të dhënave sekrete

11 Qershor, 18:57



Gjyqi për vrasjen e Martin Canit, dëshmojnë 6 persona, seanca me dyer të mbyllura, e radhës më 25 qershor

Keti Banushi

11 Qershor, 15:59

'Rikuperimi' i ish-bllokut, në korrik nis projekti! Këmbësorëve u kthehet hapësira e 'vjedhur' nga korsitë e parkimit

Blerina Goce

11 Qershor, 15:37

Tentoi të vidhte në një automjet, arrestohet 36-vjeçari në Kavajë! Në kërkim pronari i makinës

11 Qershor, 12:40

Sherr me shkopinj bejsbolli mes të rinjve në Tiranë, njëri qëllon me armë në ajër! 4 në kërkim

11 Qershor, 09:38

Bashkia e Tiranës miraton 1100 kredi të buta për familjet dhe çiftet e reja

10 Qershor, 19:20

Hapet konkurrimi për drejtues në disa komisariate, priten edhe ndryshime për shefa krimesh

10 Qershor, 18:58

IMT i konsideron të paligjshme, hiqen të gjitha strukturat e jashtme të bizneseve në stadiumin Air Albania

10 Qershor, 18:29

Megi Fino zgjidhet kryetare e Këshillit Bashkiak Tiranë, Endrit Braimllari nënkryetar! Debate në mbledhje, përjashtohet Endri Shabani

10 Qershor, 17:55

Vrasja e Martin Canit/ Publikohet momenti kur 14-vjeçari qëllohet me thikë, largohet duke vrapuar dhe mban dorën në plagë (VIDEO)

10 Qershor, 16:59

Shqipëria mirëpret Javën Kulturore Suedeze me ekspozita, koncerte dhe aktivitete

10 Qershor, 15:57

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje